Подзаконскиот акт од членот 38 став (2) од овој закон ќе се донесе во рок од 15 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон и истиот веднаш, а најдоцна во рок од 24 часа, се објавува на веб страницата на Агенцијата.

Член 61

Подзаконските акти предвидени во овој закон ќе се донесат во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 62

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

**L I G J
PËR AUTOKAMPE****Pjesa e pare****DISPOZITA TË PERGJITHSHME****1. Lenda e ligjit****Neni 1**

Ky ligj i rregullon menyren dhe proceduren për themelimin e autokampeve, proceduren për tjetërsimin e tokës ndertimore të dedikuar për autokamp, kushtet që duhen plotësuar shfrytëzuesit e autokampeve dhe ceshtje tjera lidhur me autokampet.

2. Qellim i ligjit**Neni 2**

Qellimi i këtij ligji është zhvillimi i turizmit duke tërhequr kapitalin e huaj dhe vendas për formimin e autokampeve.

3. Interesi publik**Neni 3**

Ndertimi dhe kryerja e punëve për ngritjen dhe funksionimin e autokampit është në interes publik.

4. Kuptimi i nocioneve të perdorura**Neni 4**

(1) Shprehjet e perdorura në kete ligj e kane kete kuptim:

1. Autokamp është hapësirë e rrethuar e vecante dhe e shënuar që paraqet një njesi funksionale, e formuar në perputhje me dispozitat e këtij ligji, për kampim.

2. Shfrytëzues i autokampit është çdo person vendas ose i huaj fizik ose juridik që ka lidhur marrëveshje për tjetërsim të tokës ndertimore në pronësi të Republikës së Maqedonise të dedikuar për autokamp në perputhje me kete ligj, ose është pronar i tokës ndertimore ose qiramarres i tokës ndertimore në pronësi të personit tjetër fizik ose juridik të dedikuar për autokamp dhe që ka marrë aktvendim për kategorizimin e autokampit sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Hapësirë për kampim është hapësira e autokampit ku janë formuar njësi kampimi për vendosjen e pajisjes për kampim (tenda, kampshtepize, tavoline, karrige, karrige të shtrira etj.) si dhe vendosjen e automjeteve, nese nuk është siguruar parking i vecante.

4. Kampim është qëndrimi i personave në tenda, kampshtepiza, shtepi kampimi dhe pajisje tjera perkatese për vendosje në vend të hapur në autokamp.

Pjesa e dyte**KUSHTET DHE METODA PËR THEMELIMIN
E AUTOKAMPEVE****1. Kushtet hapësinore për themelimin e autokampit****Neni 5**

(1) Autokampi themelohet në rajon për të cilin është miratuar dokumentacion i planit urbanistik për autokamp ose dokumentacion tjetër perkates i planit urbanistik në perputhje me Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik.

(2) Autokampi mund të themelohet nese toka është në pronësi të plote të Republikës së Maqedonise, ose nese toka është në pronësi të personit fizik ose juridik.

(3) Toka ndertimore në pronësi të Republikës së Maqedonise e dedikuar për autokamp tjetërsohet në perputhje me dispozitat e këtij ligji.

**2. Themelimi i autokampit në toke në pronësi të
Republikës së Maqedonise****Neni 6**

(1) Agjencia për Promovimin dhe Mbeshtetjen e Turizmit (në tekstin e metejme: Agjencia) para fillimit të procedurave për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik që do të parashikojë autokampe në toke në pronësi të Republikës së Maqedonise, paraqet njoftim të njesia e vetadmindistrit lokal në rajonin e së ciles parashihet formimi i autokampit.

(2) Njesia e vetadmindistrit lokal në afat prej dhjete ditesh pas marrjes së njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni, dorezon mendim në Agjenci.

(3) Pas kalimit të afatit nga paragrafi (2) i këtij neni, Agjencia paraqet kerkese me shkrim në Qeveri të Republikës së Maqedonise për marrje të pelqimit për themelimin e autokampit.

(4) Kerkesa nga paragrafi (3) i këtij neni duhet të përmbajë të dhëna për:

- shtrirjen e autokampit me liste të indikacioneve për ngastrat kadastrale të përfshira,
- infrastrukturen ekzistuese që duhet të ndertohet për nevojat e autokampit (rrugore, komunale, energjetike dhe llojit tjetër të infrastrukture),
- mjetet e nevojshme financiare për formimin e autokampit dhe
- mendimin e njesise së vetadmindistrit lokal, nese është paraqitur në Agjenci në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Pas marrjes së kerkeses nga paragrafi (3) i këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonise merr vendim për dhenien e pelqimit për themelim të autokampit me të cilin e percakton edhe kategorine minimale të autokampit ose e refuzon kerkesen.

3. Themelimi i autokampit në toke në pronësi private**Neni 7**

(1) Personat fizike dhe juridike që janë pronarë të tokës ndertimore apo qiramarres të tokës në pronësi të personit tjetër juridik ose fizik, që sipas dokumentacionit të planit nga neni 5 paragrafi (1) të këtij ligji është dedikuar për autokamp, paraqesin kerkese për marrje pelqimi për formimin e autokampit në Agjenci, të ciles ia bashkengjisin ekstraktin nga dokumentacioni i planit urbanistik me të cilin parashihet autokampi, elaborati gjeodezik për të dhenat numerike për token ndertimore dhe aktzoterimi me të drejten e percaktuar të pronës ose të drejten për qira të tokës për ndertim.

(2) Pas marrjes së kerkeses nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia me dokumentacionin e plote e njofton njesine e vetadmindistrit lokal në rajonin e së ciles parashihet formimi i autokampit.

(3) Njesia e vetadmindistrit lokal në afat prej dhjete ditesh pas marrjes së njoftimit nga paragrafi (2) i këtij neni, dorezon mendim në Agjenci.

(4) Pas skadimit të afatit nga paragrafi (3) i këtij neni, Agjencia paraqet kerkese me shkrim në Qeverine e Republikës së Maqedonise për marrje pelqimi për themelimin e autokampit, të ciles ia bashkengjit dokumentacionin nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe mendimin e njesise së vetadmindistrit lokal, nese i dorezohet Agjencise në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni.

(5) Pas marrjes së kerkeses nga paragrafi (4) i këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonise merr vendim për dhenie pelqimi për themelim të autokampit ose e refuzon kerkesen.

4. Organi kompetent për autokamp

Neni 8

Punet lidhur me formimin, zhvillimin dhe monitorimin e autokampeve të parapara në toke në pronesi të Republikës së Maqedonise, i kryen Agjencia në pajtim me kete ligj dhe ligj tjetër.

5. Autokampi i perkohshem

Neni 9

(1) Me perjashtim nga neni 5 i ketij ligji, autokampi mund të formohet edhe në toke që perkohesisht eshte caktuar për kampim me akt të miratuar nga Keshilli e komunes në rajonin e së ciles ndodhet toka, perkatesisht nga Keshilli i Qytetit të Shkupit nese toka gjendet në rajonin e qytetit të Shkupit.

(2) Në aktin me të cilin caktohet toka për kampim të perkohshem, caktohet organizatori i kampimit, koha për të cilën toka mund të shfrytezohet për kampim dhe kushtet minimale teknike që duhet të permbushen.

Pjesa e trete**PROCEDURA PËR TJETERSIM TË TOKES
NDERTIMORE****1. Organi kompetent dhe menyra e zbatimit
të procedures**

Neni 10

(1) Toka e dedikuar për autokamp, që eshte në pronesi të Republikës së Maqedonise tjetersohet me ankand publik nga Agjencia.

(2) Procedura e tjetersimit të tokes ndertimore në pronesi të Republikës së Maqedonise me ankand publik, zbatohet në perputhje me dispozitat e ketij ligji, me ankand publik elektronik (në tekstin e metejme: ankand publik), dhe të njejten e zbaton Komisioni për Zbatimin e Proceduresave të Ankandit Publik (në tekstin e metejme: Komisioni) i perbere nga shtate anetare i formuar nga Drejtori i Agjencise si vijon, nga një perfaqesuesi i Agjencise për Promovimin dhe Mbeshtetjen e Turizmit, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Financave - Drejtoria për Pune Pronesore Juridike, Ministria e Ekonomise dhe Agjencia e Kadastrës së Patundshmerive, dy perfaqesues nga njësia e vetadministrimit lokal në rajonin e së ciles formohet autokampi, e gjate formimit të komisionit respektohet parimi i perfaqesimit të drejte dhe adekuat i pjesetareve të bashkësisve nga njësia e vetadministrimit lokal në rajonin e së ciles formohet autokampi.

(3) Procedura e tjetersimit fillon pas shpalljes së publikuar paraprakisht, në:

- dy gazeta ditore që botohen në gjuhen maqedonase, e dalin së paku tre muaj para dates së publikimit të shpalljes dhe

- një gazete të perditshme që botohet në gjuhen që e flasin së paku 20% të qytetareve që flasin gjuhen zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase në komuna, në komuna në qytetin e Shkupit dhe në qytetin e Shkupit në rajonin e së ciles gjendet toka ndertimore lende e shpalljes, e del së paku tre muaj para dates së publikimit të shpalljes.

(4) Shpallja nga paragrafi (3) i ketij neni mund të jepet edhe në gazete të huaj të shtypur.

(5) Shpalljen nga paragrafi (3) i ketij neni, e pergatit Komisioni dhe të njejten e paraqet për mendim te njësia e vetadministrimit lokal në rajonin e së ciles gjendet toka ndertimore lende e tjetersimit, e cila jep mendim në afat prej dhjete ditësh nga marrja e njoftimit.

(6) Komisioni e paraqet për publikim shpalljen me pelqim paraprak të Qeverise së Republikës së Maqedonise.

(7) Standardet dhe kushtet minimale teknike në aspektin e pajisjes (harduerit) dhe funksionalitetin e softuerit për ankand publik elektronik i percakton Qeveria e Republikës së Maqedonise me propozim të Agjencise.

2. E drejta e pjesemarrjes

Neni 11

Për tjetersimin e tokes ndertimore në pronesi të Republikës së Maqedonise, që eshte lende e shpalljes, mund të paraqiten për pjesemarrje të gjithë personat e interesuar vendas dhe të huaj fizike dhe juridike që mund të fitojne pronesine e tokes ndertimore në territorin e Republikës së Maqedonise, në pajtim me ligjin, që i plotesojne kushtet e dhena në shpallje.

3. Permbajtja e shpalljes publike

Neni 12

(1) Shpallja për tjetersimin e tokes ndertimore në pronesi të Republikës së Maqedonise detyrimisht i permban të dhenat për:

- token ndertimore lende e tjetersimit (dedikimin, siperfaqen e parceles ndertimore, parcelat kadastrale të perfshira në parcelen ndertimore, e nese dokumentacioni i planit urbanistik i parashikon ndertimin e objekteve edhe siperfaqet e ndertimit, siperfaqen bruto të ndertuar, koeficientin e shfrytezimit, perqindjen e ndertimit, katet, dhe/ose lartesine etj)

- cmimin fillestar për meter katror të tokes ndertimore, që eshte lende e tjetersimit,

- afatin e parashtrimit dhe menyren e dorezimit të fleteparaqitjeve për pjesemarrje në ankandin publik,

- kohen e fillimit dhe kohezgjatjen e ankandit publik,

- kushtet për pjesemarrje në ankandin publik të personeve të huaj fizike dhe juridike,

- depoziten për pjesemarrje në ankand publik që eshte prej 10% deri 30% të cmimit të pergjithshem fillestar për tjetersim, si dhe llogarine ku paguhet depozita,

- obligimin e ofertuesit më të volitshem për t'i paguar mjetet në afat prej 15 ditësh nga marrja e njoftimit me shkrim për zgjedhje, permdryshe nuk do të filloje lidhja e marreveshjes, e mjetet e depozituara ofertuesit më të volitshem nuk do t'i kthehen dhe i njejti nuk do të mund të marre pjese në çdo ankand të ardhshem për parcelen ndertimore në fjale,

- perqindjen minimale që duhet të ndertohet nga tere siperfaqja e zhvilluar për ndertim, nese me dokumentacionin e planit urbanistik parashihet ndertimi i objekteve,

- afatin në të cilin bleresi eshte i detyruar të siguroje zgjidhje për kategorizimin e autokampit në perputhje me vendimin nga neni 6 paragrafi (5) të ketij ligji dhe të filloje të punoje,

- afatin e marrjes së lejes për ndertim, si dhe afatin për ndertimin e objekteve nese me dokumentacionin e planit urbanistik parashihet ndertimi i objekteve,

- menyren dhe proceduren e zbatimit të ankandit (menyren e legjitimitetit të pjesemarrjes në ankand publik, numrin e nevojshem të pjesemarrjesve, hapin minimal të rritjes së vleres për meter katror të tokes ndertimore, percaktimin e fillimit dhe fundit të ankandit publik, afatin për pagesen e ofertes më të volitshme, afatin për kthimin e depozites së paguar, obligimet për pagesen e tatimit mbi qarkullim, obligimin për shpenzime të solemnizimit të kontrates dhe të drejten e ankeses),

- faqen e internetit në të cilën kryhet ankandi publik dhe

- obligime tjera që duhet permbushur ofertuesi më i volitshem, që do të percaktohen me marreveshje për tjetersim.

(2) Afati për dorezimin e fleteparaqitjeve për pjesemarrje nuk mund të jete më i shkurter se 20 dite kalendarike as më i gjate se 60 dite duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes për paraqitjen e fleteparaqitjeve.

(3) Cmimi fillestar eshte një euro me kundervlere në denare për meter katror të tokes ndertimore që eshte lende e tjetersimit.

(4) Lartesia e hapit minimal të rritjes së vleres për meter katror të tokes ndertimore është 10% e cmimit fillestar minimal për meter katror për tjetersimin e tokes ndertimore.

(5) Komisioni detyrohet ta pergatise shpalljen sipas paragrafit (1) të ketij neni.

Neni 13

Kushtet e vecanta plotesueset që mund të perfshihen në shpallje jane:

- lartesia e qarkullimit vjetor të kapitalit të personit juridik që do të paraqitet për pjesemarrje në ankand publik,
- numri i autokampeve të ndertuara perkatesisht numri i autokampeve që menaxhohen nga personi juridik që do të paraqitet për pjesemarrje në ankand publik,
- numri i personave të punesuar te personi juridik që do të marre pjese në ankand publik,
- numri i personave që do të punesohen në autokamp,
- studimi i fizibilitetit apo plani afarist,
- personi juridik të kuotoje në një nga bursat e njohura boterore,
- personi juridik të posedoje licence, perkatese perkatesisht franshize në fushen e veprimtarise turistike,
- garancia bankare për seriozitetin e ofertes dhe/ose garancia bankare për ndertimin e objekteve në autokamp që parashihen me dokumentacionin e planit urbanistik në perputhje me dedikimin në dokumentacionin e planit urbanistik dhe
- kushtet urbanistike arkitektonike për ndertimin e objekteve në autokamp nese me dokumentacionin e planit urbanistik parashihet ndertimi i objekteve.

4. Permiresimi i shpalljes publike

Neni 14

(1) Komisioni me pelqim paraprak të Qeverise së Republikes së Maqedonise mund të kryeje permiresim të shpalljes jo më vone se 15 dite para skadimit të dites së fundit për dorezimin e fleteparaqitjes për pjesemarrje në ankandin publik të theksuar në shpallje dhe i njejt publikohet në gazeta të shtypit ku është botuar edhe shpallja. Nese deri në momentin e permiresimit jane paraqitur persona për pjesemarrje në ankand publik, Komisioni është i detyruar t'i njoftoje për permiresimin.

(2) Para marrjes së pelqimit të Qeverise së Republikes së Maqedonise, Komisioni permiresimin e shpalljes e paraqet për mendim te njesia e vetadministrimit lokal në rajonin e së ciles gjendet toka ndertimore lende e tjetersimit, e cila jep mendim në afat prej pese ditesh nga marrja e njoftimit.

5. Paraqitja për pjesemarrje

Neni 15

Pjesemarrjen në ankand publik personat e interesuar juridike dhe fizike e vertetojne me parashtrim të fleteparaqitjes me shkrim për pjesemarrje në ankand publik në të cilen shenohen të dhenat për token ndertimore për të cilen parashtruhet fleteparaqitja, për parashtruesit e fleteparaqitjes, si dhe për llogarine rrjedhese apo të transaksionit në të cilen do të kthehet depozita për pjesemarrje në ankand publik.

6. Raporti për proceduren e zbatuar

Neni 16

(1) Për çdo procedure të zbatuar për ankand publik, Komisioni detyrohet të pergatise raport dhe të njejtin të nenshkruar nga kryetari dhe anetaret e Komisionit e dorezon te drejtori i Agjencise.

(2) Në baze të raportit nga paragrafi (1) i ketij neni, drejtori i Agjencise hyn në marrevshje për tjetersimin e tokes ndertimore me ofertuesin më të volitshem në ankand publik.

(3) Nga publikimi i shpalljes deri në momentin e fillimit të ankandit publik, Komisioni me konkluzion mund ta nderprese proceduren për ankand publik, nese ndodhin rrethana të paparashikuara që do ta pamundesonin udhëheqjen e procedures për tjetersimin e tokes ndertimore në pronesi të Republikes së Maqedonise me ankand publik.

(4) Konkluzioni nga paragrafi (3) i ketij neni është baze për anulimin e shpalljes, për kete drejtori i Agjencise me propozim të Komisionit miraton aktvendim. Nese shpallja anulohet para kalimit të afatit perfundimtar për dorezimin e kerkesave për pjesemarrje, Komisioni publikon njoftim për anulimin e shpalljes në mediumet e njejta të shtypit në të cilat është publikuar shpallja.

7. Permbajtja e fleteparaqitjes për pjesemarrje

Neni 17

(1) Fleteparaqitja për pjesemarrje në ankand publik duhet t'i permbaje të gjitha të dhenat dhe deshmite e percaktuara në shpallje në menyre dhe forme siç parashihet në shpallje.

(2) Komisioni pas marrjes së fleteparaqitjeve nga parashtruesit e fleteparaqitjeve për pjesemarrje, konstaton nese fleteparaqitjet jane dorezuar në afatin e caktuar dhe të njejtat jane kompletuar, në perputhje me kushtet e shpalljes.

(3) Komisioni i informon parashtruesit e fleteparaqitjeve për kompletimin e të njejtave në menyre elektronike, në afat prej tri ditesh nga dita e paraqitjes së ofertave, me ç'rast parashtruesve të fleteparaqitjeve që kane parashtruar dokumentacion të kompletuar u dorezon emer dhe shifer shfrytezimi për pjesemarrje në ankand publik, e parashtruesve të fleteparaqitjeve që nuk kane parashtruar dokumentacion të kompletuar u dorezon njoftim me arsyetim se të njejt nuk do të marrin pjese në ankand publik.

(4) Parashtruesit e fleteparaqitjeve që kane dorezuar fleteparaqitje të kompletuara për pjesemarrje në ankand publik sipas shpalljes, në ditën e zbatimit të ankandit publik, regjistronen në faqen e internetit të cekur në shpallje me emer dhe shifer shfrytezimi për pjesemarrje në ankand publik, pas kesaj kane të drejte të marrin pjese në ankand publik.

8. Pjesemarresit në ankand publik

Neni 18

(1) Pjesemarres në ankand publik jane parashtruesit e fleteparaqitjeve që kane parashtruar dokumentacion të kompletuar dhe jane regjistruar në faqen e internetit të cekur në shpallje.

(2) Ankandi publik do të mbahet nese në shpallje është paraqitur edhe vetem një pjesemarres që i ploteson kushtet e dhena në shpallje dhe e ofron cmim më të larte se cmimi fillestar.

9. Kthimi i depozites

Neni 19

(1) Depozita për pjesemarrje në ankand publik i kthehet në teresi parashtruesit të fleteparaqitjes për pjesemarrje në ankand publik që nuk është zgjedhur si ofertuesi më i volitshem, në afat prej 15 ditesh nga dita e mbajtjes së ankandit publik.

(2) Depozita për pjesemarrje në ankand publik ofertuesit më të volitshem i kthehet e zvogeluar në perqindje prej 10%, të percaktuar për shpenzime të procedures, në afat prej 15 ditesh nga dita e pageses së shumes së pergjithshme të arritur në ankand publik për tjetersimin e tokes ndertimore.

10. Shpenzime të vecanta të procedures

Neni 20

Shpenzime të vecanta të procedures për tjetërsimin e tokës ndërtimore në pronesi të Republikës së Maqedonisë janë për aktivitete si vijojnë:

- për marrje të deshmive për parcelën ndërtimore lende e ankandit publik,
- për shpallje në medime dhe gazeta publike,
- për inspektim aty për aty dhe percaktimin e gjendjes faktike dhe
- vendosje në zoterim të tokës ndërtimore.

11. Procedura e ankandit publik

Neni 21

(1) Ankandi publik fillon me shpalljen e cmimit fillestar të tokës që është lende e shpalljes për një meter katror, e zbatohet me ankand nga pjesëmarrësit në ankand.

(2) Për procedure të kryer me sukses të ankandit publik, nevojitet që të ketë së paku një oferte graduale mbi cmimin fillestar për meter katror.

(3) Ankandi publik nuk mund të zgjase më pak se 15 minuta. Ankandi publik konsiderohet i kryer në momentin e kalimit të afatit të percaktuar në shpallje, me ç'rast nese pas mbarimit të dy minutave të fundit nga koha e caktuar për kohezgjatjen e ankandit publik nga pjesëmarrësit është dhënë oferte, afati për perfundimin e ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta, e do të perfundojë kur në periudhën e dy minutave të ardhshme nuk ka oferte të re.

(4) Ankandi publik vazhdon në kohë të pakufizuar derisa në interval kohor prej dy minutash ka oferte të re.

Neni 22

(1) Ofertues më i volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi në ankand publik që ka ofruar cmim të fundit për meter katror, që është cmimi më i lartë për tjetërsimin e tokës ndërtimore.

(2) Komisioni pas mbarimit të ankandit publik perpilon procesverbal për ankand publik të kryer dhe në menyre elektronike e paraqet te të gjithë pjesëmarrësit e ankandit publik.

(3) Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditësh nga dita e perfundimit të procedures së ankandit publik detyrohet që t'i paguaje mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Nese ofertuesi më i volitshëm në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, nuk i paguan mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni, depozita nuk i kthehet dhe nuk do të arrihet lidhja e marreveshjes.

Neni 23

(1) Për rrjedhën e ankandit publik pjesëmarrësit kanë të drejtë kundërshtimi në afat prej tri ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik. Kundërshtimi duhet të dorëzohet me shkrim të Komisioni, i cili për të njëjtin paraqet propozim të drejtori i Agjencisë, i cili në bazë të propozimit merr aktvendim në afat prej pesë diteve të punës.

(2) Kunder aktvendimit të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, me të cilin vendoset për kundërshtimin e parashtruar nga paragrafi (1) i këtij neni, pala ka të drejtë të paraqesë padi në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit të Gjykata Administrative.

(3) Procedura për ankandin publik perfundon pas mbarimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, nese nuk është paraqitur kundërshtim.

(4) Procedura për ankand publik perfundon pas aktvendimit të marrë nga paragrafi (1) i këtij neni.

12. Marreveshja për tjetërsim të tokës ndërtimore

Neni 24

(1) Pas perfundimit të procedures për ankand publik, me ofertuesin më të volitshëm, në afat prej pesë ditësh pune pas pagesës së cmimit për tjetërsimin e tokës, drejtori i Agjencisë me pelqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, lidh marreveshje për tjetërsimin e tokës ndërtimore.

(2) Marreveshja për tjetërsimin e tokës ndërtimore në pronesi të Republikës së Maqedonisë, lidhet me shkrim.

(3) Në marreveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni, zbatohen dispozitat e Ligjit për marrëdhënie obliguese.

Neni 25

(1) Marreveshja nga neni 24 i këtij ligji, vecanerisht i përmban:

- 1) palet e marreveshjes;
- 2) lenden e marreveshjes:
 - menyren e tjetërsimit,
 - të dhënat konkrete për token në fjalë dhe
 - bazën e tjetërsimit të tokës ndërtimore;
- 3) lartësinë e cmimit të shitjes, si dhe afatin e pagesës;
- 4) obligimin e bleresit për pagesën e tatimit mbi qarkullim dhe shpenzimet e noterit;
- 5) obligimin e bleresit për të siguruar zgjidhje për kategorizimin e autokampit në përputhje me vendimin nga neni 6 paragrafi (5) të këtij ligji dhe të fillojë punën në afatin e percaktuar në shpallje publike;

6) afatin për marrjen e lejes për ndërtim dhe afatin për ndërtimin e objektit në pajtim me nenin 26 paragrafi (2) të këtij ligji, nese me dokumentacionin e planit urbanistik parashihet ndërtimi i objekteve dhe

7) denimin kontraktues për mosrespektim të afateve nga paragrafi (1) pikat 5) dhe 6) të këtij neni, në lartësi prej 1,5% të cmimit të përgjithshëm të arritur të ankandit publik të tokës në fjalë për çdo muaj të kaluar në vitin e parë nga kalimi i afatit, perkatesisht 3% të cmimit të përgjithshëm të arritur të ankandit publik të tokës në fjalë për çdo muaj të kaluar në vitin e dytë nga kalimi i afatit, perkatesisht 4,5% të cmimit të përgjithshëm të arritur të ankandit publik të tokës në fjalë për çdo muaj të kaluar në vitin e tretë dhe çdo vit të ardhshëm nga kalimi i afatit.

(2) Mjetet nga arketimi i denimit kontraktues nga paragrafi (1) pika 7 të këtij neni, janë të hyra të Agjencisë.

(3) Marreveshja që nuk i përmban elementet e percaktuara në paragrafin (1) të këtij neni është e pavlefshme.

Neni 26

(1) Pas lidhjes së marreveshjes nga neni 24 i këtij ligji, shfrytëzuesi i autokampit brenda 30 ditësh të njëjten e paraqet te noteri për kryerjen e solemnizimit.

(2) Shfrytëzuesi i autokampit detyrohet të sigurojë zgjidhje për kategorizimin e autokampit në përputhje me vendimin nga neni 6 paragrafi (5) të këtij ligji dhe ta fillojë punën në afatin e percaktuar në shpallje publike, e nese me dokumentacionin e planit urbanistik parashihet ndërtimi edhe i objekteve detyrohet të marrë leje ndërtimi për objekte të parashikuara nga organi kompetent në afat prej 12 muajsh nga solemnizimi i kryer i marreveshjes për t'i ndërtuar të njëjtat në afatet e percaktuara me Ligjin për ndërtim, në të kundërtën do të paguaje denim kontraktues, në përputhje me nenin 25 paragrafi (1) pika 7 të këtij ligji.

(3) Mospermbushja e obligimit nga paragrafi (1) i këtij neni me faj të bleresit, paraqet bazë për prishjen e njëanshme të marreveshjes me ç'rast 20% e shumës së përgjithshme të tjetërsimit, nuk i kthehet bleresit.

Neni 27

(1) Në marreveshje për tjetërsimin e tokës ndërtimore në pronesi të Republikës së Maqedonisë mund të kryhen ndryshime dhe plotësime me lidhje aneksi të marreveshjes.

(2) Ndryshimet dhe plotesimet e marreveshjes nga paragrafi (1) i ketij neni mund të behen për shkaqe si vijojne:

- nese ndodhin ndryshime të lendes së marreveshjes, si rezultat i ndryshimit të dokumentacionit të planit urbanistik, por jo për shkak të ndryshimit të dedikimit dhe sipërfaqes së parceles ndertimore, për të cilën është tjetërsuar toka ndertimore,

- për heqjen e rrethanave të reja të krijuara (ndryshimi i numrit të parceles kadastrale ose ndryshimin e komunes kadastrale të tokës) në periudhën nga dita e lidhjes së marreveshjes deri në ditën e regjistrimit të marreveshjes në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmerive,

- ndryshimi statusor i shfrytëzuesit të autokampit,
- për menjanimin e gabimeve në të dhenat e pershkrimit të tokës që është tjetërsuar dhe

- shkaqe perkatesisht rrethana tjera të paparashikuara.

(3) Aneksi i marreveshjes nga paragrafi (1) i ketij neni mund të lidhet me pelqim paraprak nga Qeveria e Republikes së Maqedonise.

13. Mjete nga tjetërsimi i tokës ndertimore

Neni 28

Mjetet nga tjetërsimi i tokës ndertimore në pronesi të Republikës së Maqedonise janë të hyra të Agjencise dhe ato mund të perdoren vetem me dedikim për kryerje të punëve për të cilat Agjencia është kompetente sipas ketij ligji.

14. Rregullimi i tokës ndertimore

Neni 29

Rregullimi i tokës ndertimore deri në autokamp (ndertimi i infrastruktures rrugore dhe objekteve të infrastruktures komunale, vendosja e utesjeljesit, kanalizimit fekal dhe atmosferik dhe instalimit tjetër) kryhet nga njesite e vetedministrimit lokal dhe/ose Qeveria e Republikës së Maqedonise, e në kuader të autokampit nga shfrytëzuesi i autokampit.

15. Permbajtja e dokumentacionit të planit urbanistik

Neni 30

(1) Me dokumentacionin e planit urbanistik me të cilin parashihet autokampi mund të parashihet edhe ndertimi i objekteve në funksion të autokampit si ndertesa të dedikuara A4, B1, B2, B3, B5, B6 dhe D3 sipas Rregullores për standarde dhe normativa për planifikimin urbanistik.

(2) Me dokumentacionin e planit urbanistik për autokamp perkatesisht dokumentacion tjetër të planit urbanistik me të cilin parashihet autokampi, hapësira e kampimit duhet të jete së paku 70% e perfshirjes së planit.

16. Leje ndertimi

Neni 31

Procedura për leshimin e lejes për ndertimin e ndertesa-ve në autokamp për të cilat në pajtim me Ligjin për ndertim parashihet leje ndertimi, zbatohet në perputhje me Ligjin për ndertim, e të njejten e zbaton organi kompetent në pajtim me Ligjin për ndertim.

Neni 32

Objektet që do të ndertohen në funksion të autokampit e në të cilat do të kryhet veprimtari hoteliere, duhet t'i plotesojne kushtet për kryerjen e veprimtarise në perputhje me rregullat nga fusha e hotelierise.

Pjesa e katert

KATEGORIZIMI I AUTOKAMPEVE

1. Plani për rregullimin e hapësires për kampim

Neni 33

(1) Shfrytëzuesi i autokampit para dorezimit të kerkeses për kategorizimin e autokampit është i detyruar që t'ia paraqese Agjencise, planin për rregullimin e hapësires për kampim të parapare me dokumentacionin e planit urbanistik, që duhet të pergatitet në perputhje me kushtet e kategorizimit të autokampit nga neni 34 paragrafi (5) të ketij ligji, që kanë të bejne me hapësiren për kampim, varesisht nga kategoria e autokampit.

(2) Planin për rregullimin e hapësires për kampim me propozim të Agjencise, e miraton organi i administrates shteterore kompetent për punet e rregullimit hapësinos.

(3) Formen dhe permbajtjen e planit për rregullimin e hapësires për kampim i percakton ministri që udheheq me organin kompetent për punet e rregullimit hapësinos.

2. Kushtet e kategorizimit

Neni 34

(1) Autokampi para fillimit të kryerjes së veprimtarise detyrimisht kategorizohet në perputhje me kushtet e kategorizimit, e varesisht nga rregullimi, pajisja dhe cilesia e sherbimeve.

(2) Kategorite shenohen me numer të yjeve, me ç'rast radhitja në kategori dhe shenimi i kategorive kryhet si vijon:

- autokampe të kategorise së pare me kater yje,
- autokampe të kategorise së dyte me tre yje,
- autokampe të kategorise së trete me dy yje dhe
- autokampe të kategorise së katert me një yll.

(3) Autokampi detyrimisht duhet ta permbushe kategoria minimale të percaktuar me vendimin nga neni 6 paragrafi (5) të ketij ligji, nese toka ndertimore në pronesi të Republikës së Maqedonise e dedikuara për autokamp është tjetërsuar në perputhje me dispozitat e ketij ligji.

(4) Autokampi i parapare në toke ndertimore që nuk është tjetërsuar, në perputhje me dispozitat e ketij ligji ose që është në pronesi të personave fizike ose juridike, duhet ta permbushe kategorine e shenuar në kerkese për kategorizim të dorezuar në pajtim me nenin 36 të ketij ligji.

(5) Kushtet më të aferta për kategorizim nga paragrafi (1) i ketij neni i percakton ministri që udheheq me organin e administrates shteterore kompetent për punet nga sfera e turizmit dhe hotelierise, pas mendimit të marre paraprakisht nga Agjencia.

Neni 35

Krahas kushteve nga neni 34 paragrafi (5) të ketij ligji, autokampi duhet t'i permbushe dhe kushtet sanitarë shendetesore, kushtet për mbrojtje në pune, kushtet për mbrojtje dhe perparim të mjedisit jetesor, kushtet për mbrojtje nga zjarri dhe kushtet për mbrojtje nga zhurma të percaktuara me ligj.

3. Procedura e kategorizimit

Neni 36

(1) Para fillimit të kryerjes së veprimtarise, paraqitet kerkese për kategorizimin e autokampit në Agjenci.

(2) Me kerkese për kategorizimin e autokampit të parapare në toke ndertimore në pronesi të Republikës së Maqedonise të tjetërsuar në perputhje me dispozitat e ketij ligji dorezohen:

- 1) ekstrakti nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonise;
- 2) emri dhe selia e autokampit;

3) sherbimet që do të jene lende e punes së autokampit;
4) kopje e fletëparaqitjes për plotesimin e kushteve për pune të autokampit dhe fillimin e punes, e dorezuar në Inspektoratin Shtetëror të Tregut në përputhje me nenin 41 të këtij ligji;

5) të dhëna dhe deshmi për udhëheqesit dhe punonjësit tjerë (deshmia/diploma/certifikata e arsimit perkates dhe certifikata/deshmia për njohje të gjuhës së huaj);

6) plani i miratuar për e rregullimin e hapësirës për kampim, sipas nenit 33 të këtij ligji;

7) marrëveshja për tjetërsimin e tokës në pronësi të Republikës së Maqedonisë, nese toka ndërtimore e dedikuar për autokamp është tjetërsuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(3) Me kërkesë për kategorizimin e autokampit të parapare në tokë ndërtimore që nuk është tjetërsuar përputhje me dispozitat e këtij ligji perkatesisht që është në pronësi të personave fizike ose juridike dhe për të cilin është marrë vendim për dhenien e pelqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në pajtim me nenin 7 paragrafi (5) të këtij ligji, duhet të dorezohen:

1) ekstrakt nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë;

2) emri dhe selia e autokampit;

3) sherbimet që do të jene lende e punes së autokampit;

4) kopje e fletëparaqitjes për plotesimin e kushteve për pune të autokampit dhe fillimin e punes, e dorezuar në Inspektoratin Shtetëror të Tregut të në përputhje me nenin 41 të këtij ligji;

5) të dhëna dhe deshmi për udhëheqesit dhe punonjësit tjerë (deshmi/diplome/certifikate të arsimit perkates dhe certifikate/deshmi për njohje të gjuhës së huaj);

6) plani i miratuar për e rregullimin e hapësirës për kampim, sipas nenit 33 të këtij ligji;

7) vendimi për marrje pelqimi i miratuar në përputhje me nenin 7 paragrafi (5) të këtij ligji;

8) propozim-kategoria e autokampit dhe

9) ekstrakti nga dokumentacioni i planit urbanistik të parapare për autokamp, elaborati gjeodezik me të dhëna numerike për token ndërtimore dhe aktzoterimi me të drejten e percaktuar të pronës ose të drejtën e qirase së tokës ndërtimore.

(4) Kërkesa nga paragrafet (2) dhe (3) të këtij neni, do të dorezohet në dy ekemplare identike me një shtojcë të deshmive.

(5) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafet (2) dhe (3) të këtij neni, i percakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët e rregullimit hapësiror.

4. Aktvendimi për kategorizim

Neni 37

(1) Kategorizimin e autokampit e kryen Komisioni për Kategorizim të Autokampeve i formuar nga drejtori i Agjencisë, i përbërë nga gjashtë anëtarë si vijon, nga një përfaqësues nga Agjencia, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe nga njësisë e vetëadministrimit lokal ku është formuar autokampi, e gjatë formimit të Komisionit respektohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive të njësive së vetëadministrimit lokal ku formohet autokampi.

(2) Për kategorizimin e kryer Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni merr aktvendim në afat prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës për kategorizim.

(3) Kunder aktvendimit të përmendur nga paragrafi (2) i këtij neni mund të paraqitet ankese në Komisionin Shtetëror për Vendimarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(4) Autokampi nuk mund ta fillojë punën para se ta marrë aktvendimin nga paragrafi (2) i këtij neni, në të cilin është percaktuar kategoria nga Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 38

(1) Nese Komisioni për Kategorizim të Autokampit nuk merr aktvendim për kategorizim, perkatesisht nuk merr aktvendim për refuzimin e kërkesës për kategorizim në afatin nga neni 37 paragrafi (2) të këtij ligji, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri diteve të punës të paraqesë kërkesë të sekretaria e drejtorit të Agjencisë për marrje aktvendimi për kërkesën.

(2) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, i percakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët e rregullimit hapësiror.

(3) Me kërkesën e përmendur nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës paraqet kopje të kërkesës nga neni 36 i këtij ligji.

(4) Drejtori i Agjencisë, detyrohet që në afat prej pesë ditësh pune nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni të sekretaria e drejtorit, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni pranohet ose refuzohet. Nese drejtori nuk ka sekretari, kërkesa paraqitet të sekretaria e selisë së Agjencisë.

(5) Nese drejtori i Agjencisë nuk merr aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditësh pune.

(6) Inspektori detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e marrjes së njoftimit të përmendur në paragrafin (5) të këtij neni, të kryejë mbikeqyrje në Agjenci nese është zbatuar procedura në përputhje me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikeqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës.

(7) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikeqyrjes së kryer në përputhje me ligjin, merr aktvendim me të cilin e obligon drejtorin, që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, perkatesisht ta miratojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorezohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(8) Nese drejtori i Agjencisë nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) i këtij neni, inspektori paraqet kërkesë për fillimin e procedurës kundervajtëse për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të percaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune në të cilin Drejtori i Agjencisë do të vendosë për kërkesën e parashtruar për çfarë në afat të njëjte e njofton inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorezohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri diteve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(9) Nese drejtori i Agjencisë nuk vendos as në afatin plotësues nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditësh pune paraqet kallezim të prokurori publik kompetent dhe në këtë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(10) Nese inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë diteve ka të drejtë të dorezojë ankese të sekretaria e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nese drejtori nuk ka sekretari, kërkesa dorezohet në selinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, detyrohet që në afat prej tri ditësh pune nga marrja, ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (10) i këtij neni dhe nese konstaton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës në përputhje me paragrafet (6) dhe (7) të këtij neni dhe/ose nuk paraqet kallezim në përputhje me paragrafet (8) dhe (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurës kundervajtëse për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të percaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune në të cilin inspektori do të kryejë mbikeqyrje në orga-

nin kompetent nese procedura eshte kryer në perputhje me ligjin dhe në afat prej tri ditesh pune nga dita e mbikeqyrjes së kryer e informon parashtruesin e kerkeses për masat e marra.

(12) Nese inspektori nuk vepron edhe në afatin plotesues nga paragrafi (11) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqese kallemzim te prokurori publik kompetent kunder inspektorit dhe në afat prej tri ditesh pune e informon parashtruesin e kerkeses për masat e marra.

(13) Në rastin nga paragrafi (12) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjehere, e më së voni në afat prej një dite pune do të autorizojë inspektor tjetër për të kryer mbikeqyrje menjehere.

(14) Në rastet nga paragrafi (13) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i obliguar që brenda tri diteve të punes ta informojë parashtruesin e kerkeses për masat e marra.

(15) Nese drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në perputhje me paragrafin (11) të ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund të paraqese kallemzim te prokurori kompetent publik në afat prej tete diteve të punes.

(16) Nese drejtori i Agjencise nuk vendos në afatin nga paragrafi (9) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund të ngrite kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(17) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

Neni 39

(1) Shpenzimet e kategorizimit të autokampit i bart kerkuesi.

(2) Shpenzimet nga paragrafi (1) i ketij neni, i percaktton ministri që udheheq me organin e administrates shtetërore kompetent për punet nga sfera e turizmit dhe hotele- risë në baze të shpenzimeve të bera reale të nevojshme për kategorizim.

Neni 40

(1) Aktvendimi për percaktimin e kategorise së autokampit leshohet me vlefshmeri prej tre vitesh.

(2) Nese kryhen ndryshime në kushtet e percaktuara për kategorizimin e autokampit, shfrytezuesi i autokampit është i detyruar të paraqese kerkese për kategorizim të ri në afat prej tete ditesh nga dita e ndryshimit të kushteve të percaktuara, në të kundërtën aktvendimi për kategorizim do të anulohet.

(3) Ndryshimi i kategorise së autokampit kryhet në menyre dhe procedure të parapara për percaktimin kategorise së autokampit.

(4) Komisioni nga neni 37 paragrafi (1) të ketij ligji, në baze të kerkeses, fletëparaqitjes ose me detyre zyrtare, mund të inspektojë dhe të percaktojë nese autokampi i ploteson standardet për të cilat me aktvendim i jepet kategoria e caktuar, para kalimit të afatit nga paragrafi 1 i ketij neni. Nese Komisioni konstaton se autokampi i shmanget standardevë në baze të të cilave i është dhene kategoria e caktuar, do të paraqese propozim te drejtori i Agjencise për anulimin e aktvendimit për kategorizim.

5. Obligime të shfrytezuesit të autokampit

Neni 41

Shfrytezuesi i autokampit detyrohet që permbushjen e kushteve nga neni 40 i ketij ligji dhe fillimin e punes ta paraqese në pajtim me Ligjin për veprimtari hotelierike.

Neni 42

(1) Shfrytezuesi i autokampit mund të punojë nga ora 00,00 deri në ora 24,00.

(2) Shfrytezuesi i autokampit në menyre të pavarur e percakton orarin e punes së autokampit sipas paragrafit (1) të ketij neni, në perputhje me interesat e veta afariste dhe

nevojat e shfrytezuesve të sherbimit dhe ai është i detyruar ta paraqese orarin e punes te Inspektorati Shtetëror i Tregut në menyre dhe procedure të percaktuara në Ligjin për veprimtari hotelierike.

Neni 43

Në hyrje të kampit ose në tjetër vend të pershtatshëm për kete duhet të jete vendosur Plan - skema e kampit, lista e cmimeve për shfrytezimin e hapësires për kampim, kategoria kampit, orari i punes së autokampit si dhe sherbime tjera që i ofron kampi.

Neni 44

(1) Shfrytezuesi i autokampit doemos duhet të caktojë person përgjegjës të autokampit.

(2) Personi përgjegjës, përvë plotesimit të kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punes të percaktuara me ligj, doemos duhet të kete të paktën arsimin e mesëm, e personi përgjegjës i autokampit që është kategorizuar me kate- rje duhet të kete arsimin e lartë.

(3) Nese shfrytezuesi i autokampit e udheheq punen e autokampit personalisht, i njejt doemos duhet t'i plotesojë kushtet e percaktuara për personin përgjegjës.

(4) Personi përgjegjës është përgjegjës për punen e autokampit në pajtim me kete ligj dhe Ligjin për veprimtari hotelierike.

Neni 45

Shfrytezuesi i autokampit obligohet:

1) t'i mirembaje hapësirat dhe pajisjen dhe të ofrojë sherbime në autokamp, sipas kushteve të kategorizimit të percaktuara me aktvendim të Komisionit për Kategorizimin e Autokampit;

2) t'i paraqese cmimet për vendosje në recepsion dhe t'u mundesojë shikim në cmimet e ketyre sherbimeve shfrytezuesve të sherbimeve;

3) t'u permbahet cmimeve të paraqitura;

4) të posedojë dokumente për prodhimet e blera (fatura, fletëpagesa, fleteshoqerimi e ngjashëm);

5) për çdo shërbim të ofruar të leshojë fletellogari për specifikimin e shërbimeve nga arka fiskale;

6) në vend të dukshëm në hyrje të autokampit ta paraqese llojin e kartelave të pageses që mund të shfrytëzohen;

7) të mbaje liber të mysafireve në autokamp;

8) ta pershkruaje dhe paraqese rendin shtëpiak;

9) të ofrojë shërbime hotelierike të perfshira në pakete- aranzhmane turistike permes organizatoreve apo ndermjete- tesve të udhëtimit, perkatesisht agjencive të udhëtimit;

10) në vend të dukshëm në autokamp ta paraqese numrin e telefonit të Inspektoratit Shtetëror të Tregut dhe Agjencise;

11) në të gjitha materialet propaganduese t'i shenojë llojin dhe kategorinë e autokampit që është percaktuar me aktvendim të Komisionit për Kategorizimin e Autokampit;

12) hapësirën e kampimit ta rregullojë në perputhje me planin për rregullimin e hapësires për kampim i miratuar në perputhje me nenin 33 të ketij ligji dhe

13) të organizojë kampim në perputhje me dispozitat e ketij ligji.

Pjesa e peste

KOMPETENCA TË AGJENCISE PËR PROMOVIMIN DHE MBESHTETJEN E TURIZMIT TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE

Neni 46

(1) Agjencia i kryen punet si vijojnë:

1) kryen analize të lokacioneve të pershtatshme për autokampe;

2) parashtron iniciativa për urbanizimin e hapësires për formimin e autokampit në toke me pronesi dominuese të Republikës së Maqedonise;

3) e financon perpunimin e dokumentacionit perkates të planit urbanistik për formimin e autokampit në toke me pronesi dominuese të Republikës së Maqedonisë;

4) parashtrohet iniciativa për zbatimin e procedurës së shpronësimit për nevojat të autokampit;

5) siguron mjete dhe kryen pagesa në lidhje me procedurën e zbatuar të shpronësimit, vlerësimin e mbetimeve, të mbjellave, rrethojave dhe investimeve në parcela, për formimin e autokampit në toke me pronesi dominuese të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me dispozitat e Ligjit për shpronësim;

6) i promovon dhe reklamon autokampet dhe realizon marrëdhënie me publikun;

7) realizon bashkëpunim me organet e administratës shtetërore, njesitë e vetadministrimit lokal, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në zbatimin e kompetencave lidhur me autokampet;

8) lidh marrëveshje për tjetërsim të tokës ndërtimore, me pelqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë;

9) kryen mbikeqyrje të zbatimit të marrëveshjes për tjetërsim të tokës ndërtimore në kuader të autokampit;

10) kryen mbikeqyrje të plotësimit të kushteve në autokamp;

11) mban regjistër të autokampeve të kategorizuara;

12) ta rrethojë dhe shenojë hapësirën e autokampit pas miratimit të dokumentacionit të planit urbanistik për autokamp dhe

13) kryen edhe punë tjera lidhur me formimin, zhvillimin dhe përcjelljen e autokampit të përcaktuar me këtë ligj dhe Ligjin për themelimin e Agjencisë për Promovimin dhe Mbeshtetjen e Turizmit të Republikës së Maqedonisë.

(2) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët e hoteleise i përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të autokampeve të kategorizuara sipas paragrafit (1) pika 11 të këtij neni.

Pjesa e gjashtë

MBIKEQYRJA

Neni 47

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji, kryen Agjencia.

1. Mbikëqyrja inspektuese

Neni 48

(1) Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryen Inspektorati Shtetëror i Tregut, në përputhje me autorizimet e përcaktuara me këtë ligj ose ligj tjetër.

(2) Mbikëqyrjen e plotësimit të kushteve nga neni 35 i këtij ligji, e kryejnë organet perkatese kompetente të inspektimit, në përputhje me rregullat në fushën e hoteleise, mjedisit jetësor, marrëdhënieve të punës dhe mbrojtjes shëndetësore.

(3) Në procedurë për mbikëqyrje inspektuese zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, Ligjit për Inspektoratin Shtetëror të Tregut e mbikëqyrje në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni edhe dispozitat e ligjeve të vecanta me të cilat veprojnë organet perkatese të inspektimit, nese me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 49

Inspektorati Shtetëror i Tregut në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese detyrohet të përcaktojë, nese:

1) hapësirat dhe pajisjet mirembahen dhe ofrohen shërbime në autokampe sipas kushteve për kategorizim të përcaktuara me aktvendimin e Komisionit për Kategorizimin e Autokampeve;

2) cmimet e vendosjes janë paraqitur në recepsion dhe u mundësohet shikim në cmimet e katër shërbimeve shfrytëzuesve të shërbimeve;

3) respektohen cmimet e paraqitura të vendosjes;

4) ekzistojnë dokumente për produktet e blera (fatura, fletëpagesa, fleteshoqërimi etj);

5) për çdo shërbim të caktuar është lëshuar fletëpagesa me specifikimet e shërbimeve nga arka fiskale;

6) në vend të dukshëm në hyrje të autokampit është paraqitur lloji i kartelave të pagesës që mund të shfrytëzohen;

7) mban liber të mysafireve në autokamp;

8) e ka përcaktuar dhe paraqitur rendin shtëpiak;

9) ofrohen shërbime hotelierike të përfshira në paketë-aranzhmane turistike përmes organizatoreve apo ndërmjetesve të udhëtimit, perkatesisht agjencive të udhëtimit;

10) në vend të dukshëm në autokamp e ka paraqitur numrin e telefonit të Inspektoratit Shtetëror të Tregut dhe Agjencisë;

11) në të gjitha materialet propaganduese është shënuar lloji dhe kategoria e autokampit që është përcaktuar me aktvendim të Komisionit për Kategorizimin e Autokampit;

12) në hyrje të kampit ose në vend tjetër të pershtatshëm për këtë është vendosur Plan - skema e kampit, lista e cmimeve për shfrytëzimin e hapësirës për kampim, kategoria kampit, orari i punës së autokampit si dhe shërbime tjera që i ofron autokampi;

13) është caktuar personi përgjegjës i autokampit që i plotëson kushtet nga neni 44 paragrafi (2) të këtij ligji;

14) hapësira e kampimit është rregulluar në përputhje me planin për rregullim e hapësirës për kampim i miratuar në përputhje me nenin 33 të këtij ligji;

15) shfrytëzuesi i autokampit e ka paraqitur punën e autokampit në pajtim me Ligjin për veprimtari hotelierike;

16) shfrytëzuesi i autokampit e ka paraqitur orarin e punës në Inspektoratin Shtetëror të Tregut në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me Ligjin për veprimtari hotelierike (neni 42 paragrafi (2)) dhe

17) shfrytëzuesi ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi (2) të këtij ligji, nese ka ndryshime në kushtet e përcaktuara për kategorinë e autokampit.

2. Procedura për edukim

Neni 50

